REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 30877/1 Pro                                                                 Tiranë, 31.12. 2018

Lënda: Dërgim Udhëzimi dhe Manuali për zbatim

TË GJITHË DEKLARUESVE TË DREJTPËRDREJTË DHE TË TËRTHORTË

TË GJITHË DEGËVE DOGANORE

TË GJITHË DEPARTAMENËVE

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për njohje dhe zbatim Udhëzimin nr...............datë.................. "Mbi zbatimin praktik të deklarimit elektronik të magazinimit të përkohshëm të mallrave si dhe Manualin "Për deklarimin e mallrave në magazinim të përkohshëm –DEMP në Sistemin Asycuda World"

Të merren të gjitha masat për njohje dhe zbatim.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Belinda IKONOMI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

Zv/DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Gjon BARDHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 30877 Pro Tiranë, 31.12.2018

# UDHËZIM

Nr. 17, datë 31/12/2018

## "Mbi zbatimin praktik të deklarimit elektronik të magazinimit të përkohshëm të mallrave"

Me qëllim standartizimin e proçedurave doganore në import gjatë vendosjes së mallrave në një regjim doganor dhe informatizimin e mëtejshëm të procedurava në doganë vihet në funksionim dokumenti elektronik për magazinim të përkohshëm DEMP, meqenëse;

DEMP bën të mundur kontrollin nëpërmjet sistemit informatik të ngarkesave, nga hyrja e mallrave në territorin shqiptar deri në vendosjen e tyre në një regjim doganor, si dhe;

Në zbatim të neneve 10, 17, 23, 124 deri 141, 169 deri 181 të Ligjit Nr.102/2014, datë 30.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"- i ndryshuar, neneve 250 deri 258 dhe 737, të VKM 651, datë 10.11.2017 "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor, Manualit për proçedurat e transitit në sistemin Asycuda World; Manualin për deklarimin elektronik të mallrave në magazinim të përkohshëm –DEMP;

## UDHËZOJ:

### 1. Përkufizime

*1.1 Dokument Elektronik i Magazinimit të Përkohshëm (DEMP)* – është dokumenti elektronik që regjistrohet në sistemin asycuda world në momentin kur mallrat mbërrijnë në ambjentet e doganës

derri në vendosjen e tyre në një regjim doganor. Ky dokument në doganat e brëndshme në territorin shqiptar gjenerohet automatikisht nga sistemi në momentin kur mbyllet një deklaratë transit.

*1.2 Ambjente për magazinim të përkohshëm* - është ambjenti i rrethuar ose jo (parking) i përcaktuar nga autoritetet doganore për qëndrimin e mjeteve të transportit të mallrave dhe që administrohet nga autoritetet doganore ose nga personat fizik apo juridik të autorizuar prej tyre.

*1.3 Statusi i mallra në magazinim të përkohshëm* – mallrat janë në statusin e magazinimit të përkohshëm nga momenti i hyrjes në territorin shqiptar deri në vendosjen e tyre në një regjim doganor ose ri-eksport. Kjo periudhë kohore është 90 ditë.

*1.4 Të dhënat në deklaratën elektronike të magazinimit të përkohshëm–* janë një grup të dhënash përmbledhëse të cilat në rastin e gjenerimit automatik nga një deklaratë transit plotësohen në mënyrë automatike nga sistemi.

*1.5 Zyrat doganore ku do të përdoret DEMP*: ky dokument do të përdoret fillimisht në zyrat doganore të brëndshme: Tiranë (AL110000), Fier (AL220000), Berat (AL230000), Shkodër (AL010000), Korçë (AL170000), Elbasan (AL200000). Më pas do vijojë me zyrat e miratuara për zhdoganom lokal që janë në varësi të zyrave doganore.

## 2. Plotësimi i deklaratës transit T1.

**2.1** Proçedurat për depozitimin/regjistrimin e deklaratës T1 në degët doganore kufitare nuk ndryshon kur ngarkesa i përket një pritësi. Kur në një ngarkesë ka më shumë se një pritës plotësimi i të dhënave në T1 do të pësojnë ndryshime si më poshtë:

- Në kutinë 2 të T1 do të shënohet "GRUPAZH" .
- Në kutinë 8 të T1 do të shënohet NIPT-i i pritësit të parë që është i njëjti me NIPT-in në kutinë 31.
- Kutia 8 shfaqet në çdo "bis" dhe në rastet kur ngarkesa ka disa pritësa duhet të plotësohet në çdo rast me NIPT-in përkatës të pritësit.
- Në kutinë 33 të T1, kodi i mallrave sipas Nomenklaturës së Kombinuar të mallrave do të jetë 4-shifror.

2.2 Në të gjitha rastet ngarkesat grupazh do të peshohen në doganën hyrëse në territorin shqiptar dhe fleta e peshores do të jetë pjesë e praktikës. Kur nga doganierët konstatohen probleme në lidhje me ngarkesën dhe deklarimin në transit psh. ndryshime ndërmjet të dhënave në deklarim (të dhënat në dokumentat shoqëruese të mallrave) me ato faktike mbi mallrat (fletë pesha) do të ndiqet proçedura si vijon:

- kur sasia faktike e ngarkesës është më e madhe se ajo e deklaruar do të kryhen kontrollet e nevojshme nga doganierët përgjegjës në zyrën doganore hyrëse ku është depozituar T1. Nëse zyra doganore për arsye objektive nuk mund të kryejë kontrollin (ambjentet jo të përshtatshme, personel jo i mjaftueshëm, bllokim të lëvizjes së mjeteve) doganieri që regjistron T1 do të bëjë shënimet përkatëse në "aktin e inspektimit" në rubrikën "Rezultatet e kontrollit" do të përzgjidhet problematika e konstatuar, ndërsa në rubrikën "Informacion" do jepet informacion mbi situatën e konstatuar (shiko Manualit për proçedurat e transitit në sistemin Asycuda World).

### 3. Veprimet për mbylljen e T1/T2 dhe gjenerimin e DEMP në doganën destinacion.

**3.1** Në zyrën doganore të destinacionit në momentin që mjeti mbërrin në ambjentet e parkingut doganieri kryen proçedurat për mbylljen e T1/T2. Sistemi gjeneron në mënyrë automatike DEMP e cila tregon se mallrat gjënden në parkingun e doganës ose në ambjente të autorizuar nga dogana në pritje për tu vendosur në një regjim doganor. Të dhënat e deklaratës T1/T2 gjenerohen në mënyrë automatike në DEMP. Veprimet që kryhen nga doganieri i pikës së kontrollit të mallrave në doganat destinacion janë të pasqyruara në "Manualin për deklarimin elektronik të mallrave në magazinim të përkohshëm – DEMP", bashkëlidhur këtij udhëzimi;

**3.2** Në rastet kur ngarkesa e një mjeti ka më shumë se një pritës (grupazh), mbyllja e transitit depoziton të dhënat në sistem, por këto të dhëna duhet të transferohen në DEMP nga Përgjegjësi i Zyrës Operacionale i cili ka në varësi pikën e kontrollit të mjeteve duke ndjekur veprimet që janë pasqyruar në manualin e sipërcituar (pika 3.1).

**3.3** Doganieri i pikës së kontrollit në doganën e destinacion për të gjitha rastet kur në "aktin e inspektimit" në transit ka shënime të cilat informojnë mbi parregullsitë e konstatuara në hyrje duhet të njoftojnë menjëherë përgjegjësin e zyrës operacionale. Në varësi të rastit dhe problematikës së paraqitur zyra doganore e destinacionit do kryejë të gjitha proçedurat e nevojshme për kontrollin e

ngarkesës. Për të shmangur kontrollin e dyfishtë kjo zyrë mund të kryejë proçedurat e parashikuara në aktet normative të miratuara për rikanalizim të DAV-it.

3.4 Nëse konstatohen diferenca në peshë dhe në sasi (nr. i paketimit) rregullimet mund të bëhen në DEMP (bazuar në rezultatet e kontrollit të kryera) dhe të dhënat në DAV duhet të jenë në përputhje me të dhënat faktike. Këto ndryshime bëhen përpara se të bëhet veprimi i "mbërritjes në destinacion" nga përgjegjësi i zyrës operacionale (shiko veprimet në manual). Bazuar në Titullin IX "Shkeljet në fushën doganore, sanksionet dhe ankimimet", nenet 250 deri 281 të Kodit Doganor, këto veprime do të shoqërohen me proçes verbale si dhe vendime mbi parregullsitë e konstatuara.
Rastet e regullimeve janë të parashikuara në pikën 5-së të manualit për DEMP.

3.5 Në rastet e paraqitura në pikën 3.4. të gjitha ndërhyrjet dhe masat e marra do të pasqyrohen në aktin e kontrollit në DAV si dhe i gjithë dokumentacioni i shtuar duhet të jetë pjesë e praktikës.

## 4. Veprimet për vendosjen e mallrave në një regjim doganor.

4.1 Në të gjithë zyrat doganore të brëndëshme të paraqitura në pikën 1.5. gjatë plotësimit të DAV-it nga deklaruesit, duhet të plotësohet dhe një rubrikë e re "Dokumenti elektronik i magazinimit të përkohshëm" në të cilin bëhet lidhja automatike e DAV me DEMP. Në këtë rubrikë do të plotësohen të dhënat në lidhje me numrin e DEMP dhe numrin e artikujve. Ky veprim kryen çekimin e të dhënave në dy deklarimet në nivel artikulli në DEMP dhe të dhënat e plotësuara në DAV. Pranimi i DAV bën shkarkimin automatik të DEMP.

4.2 DEMP funksionon vetëm për rastet kur gjenerohet nga një deklaratë transiti dhe si rrjedhojë vetëm për kodet proçedurave të cilat nuk kanë proçedurë të mëparshme dmth kodet 3100, 4000, 4200, 4700, 4900, 5100, 5300, 5500, 5600, 7100, 9400. Kodi i procedurës 3100 do të përdoret në rastet kur një pjesë e ngarkesës është për rieksport ose në rastet e kthimit pa procedurë të mëparshme.
Për kodet e procedurave të tjera nuk kërkohet lidhja me DEMP.

4.3 DEMP kryen lidhjen automatike të deklaratës T1/T2 me DAV. Informacionin mbi deklaratën T1 ose T2 si dhe deklaratën DAV që i përket një ngarkese mund të merret në DEMP. Në doganat e brëndshme nuk mund të regjistrohet DAV-i nëse mallrat nuk gjënden në parkingun e zyrës doganore apo në ambjentet e miratuara nga administrata doganore për magazinim të përkohshëm dhe Doganieri

i pikës së kontrollit/përgjegjësi i zyrës operacionale nuk kryen veprimet përkatëse në lidhje me T1/T2 dhe DEMP në sistem.

5. Të tjera

5.1 NIPT-i që identifikon grupazhet në T1, "T00000000G" - "Grupazh për transit" të ç'rregjistrohet nga sistemi Asycuda World.

5.2 Të gjithë degët doganore, si dhe të gjithë deklaruesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të marrin masa për njohjen dhe zbatimin e këtij Udhëzimi si dhe të Manualit "Për deklarimin elektronik të mallrave në magazinim të përkohshëm –DEMP".

5.3 Bashkëlidhur këtij Udhëzimi është dhe manuali "Për deklarimin elektronik të mallrave në magazinim të përkohshëm –DEMP".

5.4 Ky udhëzim hyn në fuqi në datën 03/01/2019

Të merren masa për njohje dhe zbatim.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Belinda IKONOMI**

MANUAL

PËR DEKLARIMIN ELEKTRONIK TË MALLRAVE NË MAGAZINIM TË PËRKOHSHËM -DEMP

Deklarimi në Sistemin Asycuda World i mallrave që vendosen në ambjentet e magazinimit të përkohshëm do të kryhet nëpërmjet modulit për këtë qëllim, me të cilin mundësohet depozitimi në sistemin Asycuda World i Dokumentit Elektronik të Magazinimit të Përkohshëm (DEMP). DEMP është një deklaratë me të dhëna të reduktuara e cila mund:

- **Të gjenerohet nga një deklaratë transit T1/T2 në zyrën doganore të destinacionit kur këto mallra nuk janë vendosur ende në një regjim doganor.**

Deri në vendosjen e mallrave në një regjim doganor ato janë nën mbikqyrjen doganore në ambjentet e doganës (parking) apo në ambjente të magazinimit të përkohshëm të miratuara, të mbuluara nga një DEMP në sistem.

Fillimisht ky modul do të funksionojë për doganat e brëndshme duke gjeneruar DEMP nga një T1/T2. Që të gjenerohet një DEMP duhet që ngarkesa të ketë mbërritur në doganën destinacion dhe veprimet për mbylljen e deklaratës T1/T2 të jenë kryer:

- konfirmimi i mbërritjes,
- kontrolli plumceve,
- mbyllja direkt e transitit

Në vijim janë të pasqyruara veprimet që ndiqen në sistem për gjenerimin e DEMP-së nga një deklaratë T1/T2.

## 1. GJENERIMI I DEMP

Në rastet kur ngarkesa i përket një pritësi DEMP gjenerohet automatikisht. Doganieri i pikës së kontrollit me mbërritjen e ngarkesës në zyrën doganore të destinacionit duhet të kryejë veprimet e mësipërme për mbylljen e T1/T2.

**Me mbylljen e deklaratës transit sistemi gjeneron automatikisht DEMP.**

## 2. VEPRIMET NË DEMP KUR NGARKESA I PËRKET NJË PRITËSI

Pas gjenerimit të DEMP-së doganieri i pikës së kontrollit në mbjentet e magazinimit të përkohshëm kryen veprimet për konfirmimin e vendodhjes së ngarkesës në zyrën e destinacionit dhe vlerësimin e hyrjes së saj në ambjentet e parkingut të doganës. Veprimet janë si vijon:

- Asycuda/Zhdoganimi/Deklaratë/Dokument Elektronik i Magazinimit të Përkohshëm, si më poshtë:




*Fig. 01. Hyrja në DEMP*

Kërkohet DEMP e gjeneruar duke plotësuar me të dhënat mbi kodin e magazinimit të përkohshëm (parking i zyrës doganore, ambjente të miratuara) ose të dhëna nga dokumenti i mëparshëm që është deklarata transit, si më poshtë:




*Fig. 02. Kërkimi i DEMP*

Të dhënat për DEMP mund ti gjeni dhe në deklaratën transit nga e cila është gjeneruar ajo. Në kutinë 37 të T1/T2 duke klikuar në  do t'ju hapet automatikisht DEMP i gjeneruar dhe mund te merrni numrin që ka marrë nga sistemi.

Pas gjetjes së DEMP që ka lidhje me dërgesën konfirmohet mbërritja e mallrave duke kryer veprimin e mëposhtëm:

- Mbërritja e mallrave në vendndodhje




*Fig. 03. Konfirmimi i mbërritjes*




*Fig. 04. Konfirmimi i mbërritjes*

Konfirmo mbërritjen e mallrave në ambjentet e parkimit të doganës duke shtypur butonin ✓. Veprimi në vijim është miratimi hyrjes së mallrave në ambjentet e magazinimit të përkohshëm (Konfirmo Hyrjen).




*Fig. 05. Miratimi i hyrjes së mallrave*




*Fig. 06. Miratimi i hyrjes së mallrave*

Mirato hyrjen e mallrave në ambjentet e parkimit të doganës duke shtypur butonin .

Këto janë veprimet që kryhen nga dogana e destinacionit. Ngarkesa ndodhet në parkingun e doganës dhe mallrat janë në statusin e magazinimit të përkohshëm në pritje për ti vendosur në një regjim doganor. Nëse doganieri i pikës së kontrollit nuk kryen veprimet e mësipërme nuk mund të bëhet depozitimi/rregjistrimi i DAV i cili duke u lidhur me DEMP bën shkarkimin e saj.

Nëse një pritës ka më shumë se një artikull të deklaruar në transit (me "bis") gjenerohet një DEMP ku shfaqen secili artikull me rresht me vehte. Veprimet janë njësoj si për një artikull.

## 3.VEPRIMET NË DAV

Të dhënat e DEMP do të jenë të nevojshme gjatë plotësimit të DAV nga deklaruesi. Deklaruesi nëse i përket të njëjtës agjensi doganore që ka bërë deklaratën T1, mund ta marrë informacionin për DEMP-në duke klikuar në kutinë 37 të T1 në ikonën e cila hap DEMP-në.


18 Identiteti dhe kombësia e mjetit te transportit ne nisje AAA AL
19 Imt
21 Identiteti dhe kombësia e mjetit aktiv te transportit qe kalon kufirin AAA AL
25 A 31 25 B
27 Vendi i ngarkimit/shkarkimit
Invoice value EUR 1,000.00
Scaning fee EUR 129.000
Payment account
4 5
1 Kolite dhe përshkrimi i mallrave 31 L4 B1
Markat dhe numrat - Nr. i kontenierve - Sasia dhe lloji
NIPT K72221005L
i pakove
Nr dhe Lloji 10 21 Kartona
Nr e kontenierve
Pallto te medha, pallto treçerekeshe, pelerinat, mantelet, xhupa me kapuç (perfshire xhaketa
32 Artikull 1 Nr
33 Kodi tarifor 6101
Consignment Nbr 1
Storage Yes
E.S.D
35 Pesha bruto ( kg ) 10.00
38 Pesha neto ( kg ) 10.00
40 Deklarata përmbledhëse/Dokumenta te mëpars

*Fig. 07. Gjetja e DEMP në deklaratën transit*

Gjithashtu, deklaruesi mund të marrë informacion për DEMP dhe në dritaren e saj duke kërkuar me të dhënat e T1 si në fig. nr. 01 dhe 02.

Gjatë plotësimit të të dhënave në DAV është e rëndësishme plotësimi i kutisë 30 të tij, ku vendoset kodi i doganës ose kodi i ambjentit të magazinimit të përkohshëm i miratuar, i cili tregon vendndodhjen e mallrave.


14 Deklaruesi/Perfaqesuesi Nr J009
Merlin
Tirane
15 Vendi dergues/eksportues Maqedonia
16 Vendi origjines Italia
18 Identiteti dhe kombesia e mjeteve te transportit ne mberritje AAA AL
19 Kt
20 Kushtet e levrimit CIF TIRANE
21 Identiteti & kombesia e mjetit aktiv ne kufi AAA AL
22 Mon & shuma totale ne fature EUR 10
25 Menyra transpo... 31 ne kufi
26 Menyra e tran... 31 Transporti
27 Vendi i shkarkimit
28 Te dhena financiare & bankar
Kushtet e pageses
29 Zyra e hyrjes AL020000 Han i Hotit
30 Vendodhja e mallrave AL110000
Shenjat dhe numrat - Nr i kontenierit/ve - Numer dhe lloj
Shenja & nr K72221005L
32 Artikull 1 Nr
33 Kodi tarifor 61012010

*Fig. 08. Kodi i vendndodhjes së mallrave*

DEMP funksionon vetëm për rastet kur gjenerohet nga transiti dhe si rrjedhojë në kutin 37 të DAV do të përdoren vetëm kodet e proçedurave të cilat nuk kanë proçedurë të mëparshme dmth kodet 3100, 4000, 4200, 4700, 4900, 5100, 5300, 5500, 5600, 7100, 9400.
Kodi 3100 do të përdoret në rastet kur një pjesë e ngarkesës është për rieksport ose në rastet e kthimit pa proçedurë të mëparshme.

Gjithashtu, në fund të dritares së DAV është shtuar një rubrikë e re e cila bën lidhjen e DAV me DEMP, pamja në vijim:



*Fig. 09. Rubrika që plotësohet në DAV*



*Fig. 10. Lidhja e DAV me DEMP*

Siç shihet nga pamja e mësipërme në njërën pjesë plotësohen të dhënat e DEMP-së , kodi doganës, viti, numri i DEMP, numri i artikullit. Numri i artikullit në DEMP jep të dhënat mbi atë artikull të cilat duhet te jenë të njëjta me të dhënat e artikullit në DAV. Sistemi bën çekimin e të dhënave dhe nëse ka mos përputhje nuk bën lidhjen e dy dokumenteve DAV dhe DEMP.




*Fig. 11. Pasqyrimi i të dhënave të artikullit*

Duke vendosur numrin e artikullit sistemi automatikisht plotëson të dhënat e artikullit të DEMP dhe të artikullit të DAV dhe duke klikuar në sistemi automatikisht bën shkarkimin e artikullit nga DEMP.




*Fig. 12. Shkarkimi i të dhënave nga DEMP*

Nëse plotësohet një e dhënë gabim në DAV, p.sh kodi i vëndit eksportues sistemi nuk lejon shkarkimin e DEMP, në vijim pamja:




*Fig. 13. Plotësimi gabim i DAV*

Nëse DEMP ka dy ose më shumë artikuj (dhe DAV do të ketë po aq artikuj), pasi shkarkohet artikulli i parë do të ndiqen të njëjtat veprime duke ndryshuar numrin e artikujve psh 2 në DEMP që i korrenspondon 2 në DAV. Dhe kështu vijohet për të gjithë artikujt. Në vijim pamja:




*Fig. 14. Shkarkimi i artikullit të dytë*

Pasi pranohet DAV bëhet dhe shkarkimi i DEMP dhe në DEMP shfaqet dhe numri i DAV dhe të dhënat e mallrave të shkarkuara nga ai. Në vijim pamja:



Permbledhesja e shkarkimit

Deklarimi i Meparshem — Deklarata e shkarkuar

| Tipi | Zyra | Regjistrimi | Art | Kodi Tar... | Pr... | Tsc | Origj. | Art | Sasia. Shkar... | Kg.shkarkuar | Nj.S.Shkarkuar | Vlera Ref. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| SAD | AL110000 | 07/12/2018 R 107926 | 1 | 61012010 | 0... | | IT | 1 | 10 | 10.0000 | 10.0000 | 0.0 |

*Fig. 15. Të dhënat e DAV në DEMP*

Sistemi paraqet DEMP në dritaren me të dhënat kryesore të tyre me ngjyra të ndryshme sipas statusit që ajo ndodhet në sistem. Kur DEMP është në statusin e gjeneruar (nuk është miratuar hyrja, vetëm është mbyllur T1/T2) ajo ka ngjyrë gri, kur është në statusin "miratuar hyrja" ka ngjyrë të bardhë dhe kur është në statusin "e shkarkuar" ajo ka ngjyrë të kuqe. Në vijim pamja:



Dokumenti Elektronik i Magazinimit te Perkohshem kerkim

46 documents found! Please select a document and select an action from the local menu

| Zyra desti... | Viti R... | Nr. Rregj... | S... | Data Rregj.... | Kodi i ven... | ... | Ti... | Ref Meparsh. | Numri Regj. Meparsh. | Data Regj. ... | S... | T... | Kodi ... |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| AL200000 | 2018 | 0000007 | S | 22/11/2018 | AL200000 | | T1 | 18ALAL140... | 18ALAL140000002... | 22/11/2018 | D | 7 | J100 |
| AL110000 | 2018 | 0000025 | S | 23/11/2018 | AL110000 | | T1 | 18ALAL140... | 18ALAL140000002... | 23/11/2018 | D | 25 | J009 |
| AL220000 | 2018 | 0000001 | S | 23/11/2018 | AL220000 | | T1 | 18ALAL150... | 18ALAL150000001... | 22/11/2018 | D | 1 | J030 |
| AL140000 | 2018 | 0000001 | S | 23/11/2018 | AL140000 | | T1 | 18ALAL150... | 18ALAL150000001... | 22/11/2018 | D | 1 | J030 |
| AL110000 | 2018 | 0000026 | S | 26/11/2018 | AL110000 | | T1 | 18ALAL140... | 18ALAL140000002... | 26/11/2018 | D | 26 | J030 |
| AL110000 | 2018 | 0000027 | S | 26/11/2018 | AL110000 | | T1 | 18ALAL140... | 18ALAL140000002... | 26/11/2018 | D | 27 | J009 |
| AL220000 | 2018 | 0000002 | S | 26/11/2018 | AL220000 | | T1 | 18ALAL140... | 18ALAL140000002... | 26/11/2018 | D | 2 | J030 |
| AL110000 | 2018 | 0000028 | S | 27/11/2018 | AL110000 | | T1 | 18ALAL140... | 18ALAL140000002... | 27/11/2018 | D | 28 | J030 |
| AL110000 | 2018 | 0000029 | S | 27/11/2018 | AL110000 | | T1 | 18ALAL140... | 18ALAL140000002... | 27/11/2018 | D | 29 | J009 |
| AL140000 | 2018 | 0000002 | S | 04/12/2018 | AL140000 | | T1 | 18ALAL150... | 18ALAL150000001... | 04/12/2018 | D | 2 | J009 |
| AL230000 | 2018 | 0000001 | S | 04/12/2018 | AL230000 | | T1 | 18ALAL140... | 18ALAL140000002... | 04/12/2018 | D | 1 | J030 |
| AL010000 | 2018 | 0000001 | S | 04/12/2018 | AL010000 | | T1 | 18ALAL140... | 18ALAL140000002... | 04/12/2018 | D | 1 | J030 |
| AL010000 | 2018 | 0000002 | S | 05/12/2018 | AL010000 | | T1 | 18ALAL150... | 18ALAL150000001... | 05/12/2018 | D | 2 | J030 |
| AL110000 | 2018 | 0000030 | S | 05/12/2018 | AL110000 | | T1 | 18ALAL140... | 18ALAL140000002... | 05/12/2018 | D | 30 | J100 |
| AL110000 | 2018 | 0000031 | S | 05/12/2018 | AL110000 | | T1 | 18ALAL140... | 18ALAL140000002... | 05/12/2018 | D | 31 | J100 |
| AL110000 | 2018 | 0000032 | S | 06/12/2018 | AL110000 | | T1 | 18ALAL140... | 18ALAL140000002... | 06/12/2018 | D | 32 | J030 |

*Fig. 16. DEMP sipas statusit*

## 4. NGARKESA GRUPAZH ME DISA PRITËSA

### 4.1 Plotësimi i T1

Në rastet kur ngarkesa është grupazh domethënë një ngarkesë përbëhet nga disa dërgesa me pritësa të ndryshëm, sistemi gjeneron për secilin pritës DEMP më vehte të cilat lidhen me të njëjtën deklaratë transit.

Deklarata transit në këto raste do të plotësohet si më poshtë:

- Në kutin 2 do të shënohet "GRUPAZH" .
- Në kutinë 8 do të shënohet NIPT-i i pritësit të parë që është i njëjti me NIPT-in në kutinë 31.
- Kutia 8 shfaqet në çdo "bis" dhe duhet të plotësohet në çdo rast me NIPT-in përkatës të pritësit.
- Në kutinë 33 të T1, kodi i mallrave sipas Nomenklaturës së Kombinuar të mallrave do të jetë 4-shifror.

Pamjet në vijim tregojnë mënyrën e duhur të plotësimit të deklaratës transit në rastet e grupazhit. Në faqen e parë plotësohen të dhënat me pritësin i cili zë volumin më të madh në ngarkesë dhe për pritësit e tjerë vijohet me BIS-et.




*Fig. 17. Plotësimi T1/T2*

Nëse pritësi i parë ka më shumë se një artikull shtohen bis-et për të gjithë artikujt që i përkasin atij. Pasi mbarojnë artikujt e pritësit të parë vijohet për të shtuar pritësin tjetër duke klikuar në ikonën  "shto pritës". Pasi është shtuar pritësi në kutinë 8 (të shfaqur në bis) dhe 31 të bis-it, plotësohen të dhënat mbi secilin artikull që i përket këtij pritësi (në varësi të numrit të artikujve). Dhe kështu vijon me të gjithë dërgesat që ka një ngarkesë grupash.




*Fig. 18. Shtimi i një pritësi*

Në shembull pritësi i parë ka dy artikuj, pasi plotësohet T1 për dy artikujt shtohet pritësi i dytë. Theksojmë që në Bis duhet të plotësohet NIPT-i i pritësit në kutinë 8 të shfaqur në bis më pas në kutinë 31.




*Fig. 19. Plotësimi i të dhënave për pritësin e shtuar*

Pasi plotësohen të dhënat për të gjithë pritësit depozitohet T1 dhe kryhen të gjitha veprimet për regjistrimin e tij nga dogana hyrëse. Nëse gjatë verifikimit/kontrollit konstatohen ndonjë mospërputhje për të cilat dogana hyrëse kërkon të njoftojë doganën destinacion ato shënohen në aktin e konstatimit në rubrikën "Rezultatet e kontrollit" dhe "Informacion".




*Fig. 20. Plotësimi i aktit të inspektimit*

## 4.2 Veprimet në doganën e destinacionit për grupazhet

Doganieri i pikës së kontrollit (sipas detyrave funksionale të përcaktuara) kryhen veprimet për mbylljen e deklaratës transit T1/T2 :

- Mallrat në mbërritje
- kontrolli plumceve,
- mbyllja direkt e transitit

Në momentin kur bëhet mbyllja direkt e transitit shfaqet akti i inspektimit. Në rastet kur në aktin e inspektimit ka shënime të zyrës nisëse në "rezultatet e kontrollit" dhe "informacion" mbi mospërputhjet e konstatuara, doganieri i pikës së kontrollit njofton përgjegjësin e zyrës operacionale i cili sipas rastit merr masat për rikanalizim të DAV-it që do të depozitohet për këtë ngarkesë.

Përgjegjësi i Zyrës Operacionale që ka në varësi pikën e kontrollit duhet të kryejë dhe veprimet për gjenerimin DEMP dhe vlefshmërinë e saj.

Veprimet në sistem janë paraqitur në vijim:




*Fig. 21. Selektimi i T1 dhe gjenerimi i DEMP*

Pas "magazino" shfaqen të listuar të gjithë pritësit e mallrave që janë deklaruar në transit.




*Fig. 22. Dy pritës*

Për secilin pritës kryhet gjenerim i DEMP-së më vehte duke kryer hapat si vijon:
Selektohet pritësi i parë dhe kryhen veprimet për gjenerim (magazino).




*Fig.23. Zgjidh ngarkesën për magazinim*




*Fig. 24. Gjenerimi  DEMP-së për pritësin e parë*




*Fig. 25. Krijimi i DEMP*

E njëjta mënyrë ndiqet për secilin pritës më vehte




*Fig. 26. Gjenerimi DEMP-së për pritësin e dytë*

Për secilin pritës gjenerohet nga një DEMP më vehte. Më pas veprimet vijojnë me mberritjen dhe miratimin e hyrjes në magazinim të përkohshëm.
Në dritaren:

- **Asycuda/Zhdoganimi/Deklaratë/Dokumenti elektronik i magazinimit të përkohshëm**

gjejmë DEMP-të e secilit pritës që i përkasin një deklarate transit.



*Fig. 27. Gjetja e DEMP*



*Fig. 28. Një transit- dy pritësa – dy DEMP*

Siç shihet më lart sistemi ka gjeneruar 2 DEMP për një transit me dy pritësa të ndryshëm. Për secilën DEMP kryhen të njëjtat veprime si në pikën 2 (mbërritja dhe miratimi i hyrjes së mallrave në ambjentet e magazinimit të përkohshëm) dhe në pikën 3 për secilin pritës.

Veprimet e pasqyruara në figurat e mësipërme janë proçedurat normale që do të ndiqen në zbatimin e deklarimit në sistemin Asycuda World të DEMP-it.

## 5. Proçedurat në rastet e parregullsive

**5.1** Në rastet kur konstatohen parregullsi në deklaratën T1 (diferenca në peshë apo numri i pakove), të konstatuara nga dogana hyrëse apo dogana e destinacionit, bazuar në verifikimet dhe vendimin e marrë nga dega doganore e destinacionit, ndryshimet mund të bëhen në DEMP në dritaren "pesha në hyrje" / "pakot në hyrje" ku vendoset pesha/nr. pakove faktike të konstatuara nga kontrolli. Doganieri i pikës së kontrollit njofton përgjegjësin e zyrës operacionale mbi shënimet në aktin e inspektimit (të bëra nga zyra doganore hyrëse dhe fletë peshimin). Ndryshimet në DEMP do të bëhen nga përgjegjësi i zyrës operacionale si në rastin me një pritës ashtu dhe në rastin me shumë pritësa (grupazh).


Arritur ne destinacion
ASYCUDA
Dokumenti Elektronik i Magazinimit - Segment i Pergjithshem

D.E.M.P. AL110000 Tirana

2 Eksportuesi Nr.
GRUPAZH
ITALI

Referenca D.E.... AL110000/111218/0000033
Dok. i meparsh... 18ALAL14000000293913 T1 Ngarkesa
5. Artikujt 2 6 Nr Pakove 20 Detajet e Rregjistrimit 2018 0000033 11/12/2018

8 Importuesi Nr. K72221005L
BEKA -K 07
Rr.3 DESHMORET, KASHAR, YZBERISHT
Nr.
TIRANE
TIRANE

Identifikimi i vendodhjes AL110000 Data mbarimit 12/03/2019

Adresa e vendodhjes se mallit

14 Deklaruesi Nr. J009
Mirlin
Rr

| Art | Kodi Tarifor | Prec | Tsc | T1 Pesha filles... | Pesha ne Hyrje | Pesha e mbetur | T1 pakot fillest... | Pakot ne hyrje | Pakot e mbetura |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 6101 | | | 100.0000 | 110.0000 | 100.0000 | 10 | 12 | 10 |
| 2 | 6202 | | | 100.0000 | 90.0000 | 100.0000 | 10 | 9 | 10 |

*Fig. 29. Ndryshimet në DEMP*

Në vijim mbyllja manuale kur mbetet peshë pjesërisht pa u shkarkuar nga DEMP:




*Fig. 30. Shkarkimi manual i DEMP*

**Kujdes : Ndryshimet në DEMP mund të bëhen para se të kryhen veprimet "Arritur në destinacion" dhe "Konfirmo hyrjen". Nëse është konfirmuar hyrja nuk mund të ndryshojë pesha/pakot në hyrje në DEMP.**

**5.2** Në rastet kur doganieri i pikës së kontrollit i ka bërë veprimet e sipërcituara dhe dega doganore vendos që ndryshimet të pasqyrohen në DAV, atëherë do të veprohet si vijon:

- Kur pesha faktike është konstatuar më e vogël se ajo e deklaruar në T1/DEMP do të plotësohet DAV duke vendosur peshën faktike dhe si rrjedhojë DEMP do të shkarkohet pjesërisht (vetëm me peshën faktike të DAV) dhe pjesa e mbetur do të shkarkohet manualisht nga përgjegjësi i zyrës operacionale.

- Kur pesha faktike është konstatuar më e madhe se ajo e deklaruar në T1/DEMP, do të plotësohet DAV duke vendosur peshën faktike dhe si rrjedhojë DEMP do të shkarkohet plotësish. Por në këtë rast do të ketë peshë të ndryshme në deklarata T1/DEMP me peshën në DAV.

**5.3** Në rastet kur këto diferenca konstatohen pasi është regjistruar DAV (nga kanalizimi në profilet e riskut etj.), atëhere do të korigjohet DAV nga personat përgjegjës sipas detyrave funksionale.

- Të gjitha ndryshimet duhet të shoqërohen me shpjegimet përkatëse në "aktin e kontrollit" si dhe me dokumentat shtesë sipas rastit në praktikë.

Ky manual paraqet vetëm rastin kur DEMP gjenerohet nga një deklaratë transit T1/T2 në doganat e brëndshme të territorit shqiptar. Me vënien në funksion të DEMP dhe në doganat kufitare do të bëhet përditësimi i manualit.